## SYLLABUS I LËNDËS “E DREJTA DIPLOMATIKE DHE KONSULLORE”

| **Të dhëna bazike të lëndës** | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | **Fakulteti Juridik** |
| **Titulli i lëndës:** | **E Drejta Diplomatike dhe Konsullore** |
| **Programi:** | **Juridik i Përgjithshëm** |
| **Niveli:** | **Bachelor** |
| **Statusi lëndës:** | **Zgjedhore** |
| **Viti i studimeve:** | **III** |
| **Numri i orëve në javë:** | **2+1** |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | **4** |
| **Koha / lokacioni:** | **09:00 - 10:30** |
| **Mësimdhënësi i lëndës:** | **Prof. asoc. dr. Halim BAJRAKTARI** |
| **Të dhënat kontaktuese:** | **halim.bajraktari@uni-prizren.com** |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës:** | Kjo lëndë do t'u ofrojë studentëve njohur bazë në të kuptuarit e marrëdhënieve diplomatike dhe konsullore dhe atë: nocionin dhe teoritë e ndryshme diplomatike; historinë e diplomacisë; themelimin e misioneve diplomatike, imunitetet dhe privilegjet e tyre; themelimin dhe funksionimin e misioneve konsullore, imunitetet dhe privilegjet e tyre; korrespodenca diplomatike; shërbimi i jashtëm i Republikës së Kosovës; protokolli diplomatik; diplomacia e Bashkimit Europian, etj.<br><br>Përveç kësaj studentëve do t'u ofrohen shembuj dhe raste të ndryshme praktike lidhur me themelimin dhe funksionimin e misioneve diplomatike dhe konsullore; rate praktike gjyqësore lidhur me imunitetet dhe privilegjet diplomatike dhe konsullore, me qëllim që t'i kuptojnë në mënyrë analitike funksionimin dhe problemet e përfaqësimit të shteteve në shtete të tjera. |
| | |
| **Qëllimi i lëndës:** | E drejta diplomatike dhe konsullore ka për qëllim që studentët të inkurajohen të mësojnë dhe studiojnë pikëpamjet, rolin e diplomacies misionin dhe rendësin e saj për shtetit. Njohjen e shteteve nuk ka qëllim vetëm edukativ dhe infromues, por në radhë të parë synon të nxis mendimin analitik, logjikën e të menduarit mbi të drejtën, të aftësojë studentët që të marrin pjesë në debat, t'i mësojë të argumentojnë tezat e tyre, të formulojnë pyetje e kështu me radhë. |
| | |

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit**: | Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët janë në gjendje:<br><br>(1) Të kuptojnë dhe shpjegojnë parimet themelore të artit të diplomacies dhe zhvillimin historik të diplomacisë;<br><br>(2) Të fitojë njohuri themelore në kuptimin e marrëdhenieve diplomatike dhe ato konsullore dhe të bëjë dallimin ndërmjet tyre;<br><br>(3) Të dallojnë institucionet që e përfaqësojnë shtetin në organizata ndërkombëtare;<br><br>(4) Të kuptojë procesin e funksionimit të marrëdhënieve diplomatike dhe konsullore;<br><br>(5) Të identifikojnë dhe kuptojnë kushtet ligjore në bazë të të cilave përfaqësuesit diplomatikë dhe konsullorë jetojnë dhe punojnë në shtetinpranues;<br><br>(6) Të fitojë aftësi shkrimi dhe prezentimi në fushën e diplomacies. |

| **Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)** | | | |
|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithsej** |
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 1 | 15 | 5 |
| Punë praktike | 1 | 15 | 15 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 4 | 4 |
| Ushtrime në terren | 2 | 6 | 6 |
| Kollokfiume, seminare | 2 | 2 | 4 |
| Detyra të shtëpisë | 1 | 5 | 5 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 1 | 7.5 | 7.5 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 1 | 5 | 5 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final) | 1 | 10 | 10 |
| Projektet, prezantimet ,etj | 1 | 7.5 | 7.5 |
| **Totali** | | | **99 orë (4 ECTS)** |

| | |
|---|---|
| **Metodologjia e mësimdhënies:** | Puna me studentë si në ligjërata ashtu edhe në ushtrime do të jetë një punë kualitative, me ligjërata dhe ushtrime të |

| | |
|---|---|
| | kapshme përmes shembujve si dhe një ligjërim modern duke iu referuar metodave didaktike bashkekohore te platformave fizike dhe online. Po ashtu gjate ligjeratave dhe ushtrimeve do te mesohet dhe do te ligjerohen njohuri edhe nga praktikat e ndryshme diplomatike e vendeve te huaja si dhe ceremonialin dhe protokollin diplomatik.<br><br>Studentët do të kenë mundësi të shkruajnë punime seminarike, të trajtohen raste praktike nga e drejta diplomatike dhe konsullore nëpërmjet punës në grupe, etj. |
| **Metodologjia e vlerësimit:** | Kollokfiumi llogaritet i sukseshumë nëse studenti i arrinë 51% të pikëve të mundëshme (100).<br><br>-Provimi llogaritet i sukseshumë nëse studenti i arrinë 51% të pikëve të mundëshme (100).<br><br>-Çdo student duhet t´i nënshtrohet provimit!<br><br>-Nëse nota e kollokfiumit të sukseshëm është më e lartë se ajo e provimit të sukseshumë, atëher do të nxirret nota mesatare si notë përfundimtare.<br><br>Në të gjitha rastet tjera vlenë vetëm nota e provimit.<br><br>Pjesëmarrja dhe angazhimi në mësim prezentime te punimeve do të vlersohet me 10% të pikëve të mundëshme (100) |
| **Literatura** | |
| **Literatura primare:** | Eqrem Zenelaj, E Drejta Diplomatike e Konsullore, „VATRA“ – Prishtinë, 2014.<br><br>- Eqrem Zenelaj, Historia e Diplomacisë, VATRA“ – Prishtinë, 2012<br><br>-Borut Bohte, Vasilka Sancin, E Drejta Diplomatike dhe Konsullore (Prishtinë, Kolegji Victory, 2011.<br><br>- Zejnullah Gruda: E drejta ndërkombëtare publike. Botim i plotësuar dhe i përmirësuar 2009 |
| **Literatura shtesë:** | - Zejnullah Gruda, Manual Diplomatik, Prishtinë, 2009.<br><br>- Ludwik Dembinski, The Modern Law of Diplomacy. External missions of states and international organizations. |

| | |
|---|---|
| | Dordrecht, Boston, Lancaster: Martinus Nijhoff Publishers, 1998.<br><br>- Çdo libër nga e Drejta Ndërkombëtare Publike, pjesa mbi të Drejtën Diplomatike dhe Konsullore,<br><br>- Eilen Deenza, Diplomatic Law, Commentary on the Vienna Convention on Diplomatic Relations, Oxford Comentaries on International law, third edition, 2008,<br><br>-Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, Vjenë1961;<br><br>-Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore, Vjenë 1963<br><br>-Ligji për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës;<br><br>-Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës;<br><br>-Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe<br><br>Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovësë;<br><br>-Ligji për Statusin, Imunitetet dhe Privilegjet e Misioneve Diplomatike, Konsullore dhe<br><br>Personelin e Kosovës dhe Praninë Ndërkombëtare Ushtarake si dhe personelin e saj;<br><br>-Ligji për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës |
| | |

| **Plani i dizajnuar i mësimit:** | | |
|---|---|---|
| **Java** | **Ligjërata** | **Ushtrime** |
| Java e parë: | Përmbajtja, organizimi, metodologjia dhe metodat e vlerësimit.<br>-Historia e diplomacisë<br>-Diplomacia Greko Romake, diplomacia Mesjetare. | Hyrje<br><br>Prezantim për metodologjinë mbajtjes së ushtrimeve |

| | | |
|---|---|---|
| | | Metodat e vlerësimit në ushtrime dhe adresimi i punëve i punëve seminarike dhe ushtrimeve |
| Java e dytë: | -Nocioni diplomaci-diplomati<br>-Misionet diplomatike- llojet<br>-Teorite e ndryshme mbi diplomacine | Shqyrtim i legjislacionit për llojet e misioneve diplomatike<br><br>Teoritë e ndryshme mbi diplomacinë |
| Java e tretë: | -Sfondi historik i zhvillimit të Marrëdhënieve Diplomatike dhe Konsullore<br>-Misioni i përhershëm diplomatik<br>-Zhvillimi i të drejtave mbi privilegjet dhe imunitetet diplomatike. | Shqyrtimi I dallimeve ndërmjet misioneve diplomatike dhe konsullore.<br><br>Prezentim nga studentët për misionet e përhershme diplomatike |
| Java e katërt: | -Burimet Formale të së Drejtës Diplomatike dhe Konsullore<br>-Konventa e Vjenës mbi Marrëdheniet Diplomatike (1961) -E Drejta Zakonore -E Drejta Nderkombetare Diplomatike Kontraktuese<br>-Konventat Konsullore -Trashëgimi i Republikes së Kosovës në konventat ndërkombëtare mbi të drejtën diplomatike dhe konsullore nga RSFJ.<br>-Burimet e brendshme juridike (te Kosoves) te se drejtës Diplomatike dhe Konsullore. | Hulumtimi dhe prezentimi nga studentët për legjislacionin e Kosovës për Misionet Diplomatike dhe konsullore.<br><br>Puna ne grupe |
| Java e pestë: | -Themelimi i një misioni të përhershëm diplomatik (hapja e ambasadave)<br>-Personeli i ambasadës (dekretimi dhe akreditimi i diplomateve) | Trajtimi i procedurës së hapjes së misioneve diplomatike. Shqyrtimi i legjislacionit të Republikës së Kosovës dhe misionet e saj. |
| Java e gjashtë: | -Persona grata dhe Persona non grata | Shembuj praktik nga shpallja non- grata e personelit të misioneve. |

| | | |
|---|---|---|
| | -Detyrat dhe përgjegjesit e shefit të një misioni diplomatik | |
| Java e shtatë: | Test mes-semestral (kolokuium) | |
| Java e tetë: | - Privilegjet dhe imunitetet e diplomateve (llojet) shuarja e misioneve diplomatike | Raste studimi nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë për misionet diplomatike. |
| Java e nëntë: | - Misionet e përhershme pranë organizatave ndërkombëtare.<br>-Imunitetet dhe privilegjet e tyre. | Hulimtimi dhe prezentimi i studentëve për misionet e përhershme pranë organizatave ndërkombëtare.<br>Raste studimi për imunitetet e tyre. |
| Java e dhjetë: | -E drejta konsullore - themelimi i marrëdhënjeve konsullore mes Shteteve | Prezantimi i studentëve<br><br>Themelimi I Misioneve konsullore: në veçanti Republikën e Kosovës. |
| Java e njëmbëdhjetë: | -Imunitetet dhe privilegjet konsullore<br>-Shuarja e misioneve konsullore | Raste studimi nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë për misionet konsullore. |
| Java e dymbëdhjetë: | -Komunikimi dhe korrespodenca diplomatike | Pune ne grupe dhe prezentimi i studentëve për komunikimin dhe korrespodencën diplomatike.<br>Luajtja e roleve në komunikim diplomatike. |
| Java e trembëdhjetë: | -Shërbimi i jashtëm i Republikës së Kosovës | Shqyrtimi I Ligjit për Shërbimin e jashtëm të RKS dhe prezentimi I rasteve. |
| Java e katërmbëdhjetë: | -Protokolet diplomatike<br>-Diplomacia e Bashkimit Evropian | Prezentimet e studentëve. |
| Java e pesëmbëdhjetë: | -Pergatitje për provim perfundimtar<br>Debate. | FInalizimi I vlersimeve për studentet |

**Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

- Studentet duhet të kenë vijueshmëri të rregullt në ligjerata dhe ushtrime, ku vijueshmëria do të evidentohet nëpërmjet listës së prezencës të studentëve në ligjërata dhe ushtrime.
- Pjesëmarrja e rregullt në ligjërata dhe ushtrime, prezentimi i punimeve seminarike dhe aktivitete të tjera do të llogariten në notën përfundimtare.
- Në ligjërata dhe ushtrime të trajtohen vetëm temat e parapara me ketë planprogram.
- Komunikimi me studentët do të bëhet kryesisht përmes emailit dhe postimit të njoftimeve në objektet e Universitetit dhe personalisht gjatë konsultimeve